



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 58 datë 30.12.2015

PËR

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2016-2018 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2016”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 19, nenit 32, shkronja “dh”, nenit 33, pika 3 dhe nenit 44, shkronja “a” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.115/2014 për “Ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Shqipëri” (i ndryshuar); neneve 6, 15, 17 dhe 32 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 2 dhe nenit 10 të ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 29.03.2012 për “Procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2016-2018 si më poshtë vijon.

1.1 Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2016-2018, është në shumat si më poshtë:

Plani i të ardhurave	2016	2017	<i>Në lekë</i> 2018
Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	10,823,928,000	11,000,000,000	11,622,900,000
- Të ardhura tatimore	6,677,428,000	7,055,000,000	7,456,000,000
- Të ardhura jo tatimore	4,146,500,000	4,340,000,000	4,566,900,000
Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	1,531,458,969	1,562,088,148	1,593,329,911
Totali	12,355,386,969	12,957,088,148	13,616,229,911

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2016-2018, është në shumat si më poshtë:

Plani i shpenzimeve	<i>Në lekë</i>		
	2016	2017	2018
Shpenzime korrente	7,528,083,137	8,414,068,111	9,249,231,901
Shpenzime kapitale	4,827,303,832	4,543,020,037	4,336,998,010
Totali	12,355,386,969	12,957,088,148	13,616,229,911

1.3 Transferta specifike për financimin e funksioneve të reja është si më poshtë:

	<i>Në lekë</i>		
	2016	2017	2018
Transferta specifike për financimin e funksioneve të reja	858,083,605	875,245,277	892,750,183

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016 si më poshtë:

- 2.1 Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës Nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.2 Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës Nr.2, si dhe lidhjet e pagave nr. 1,2,3,4,6,15 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.3 Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.3 dhe Nr.3/1 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.4 Të miratojë detajimin dhe shpërndarjen e transfertës specifike për financimin e funksioneve të reja sipas Pasqyrës Nr.3/2 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.5 Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve sipas Pasqyrës Nr.4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.6 Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2016.

3. Të miratojë shfuqizimin e vendimeve: Nr.8 datë 05.04.2012 mbi “Krijimin e Galerisë së Artit Bashkëkohor, Tiranë “T.A.G. contemporary” dhe miratimin e strukturës organizative”, Nr.76 datë 20.12.2005, “Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpenzimeve për Njësinë e Zbatimit të projektit për ndërtimin dhe rehabilitimin e shkollave të Tiranës” dhe Nr.48 datë 11.09.2006, “Për ngritjen e strukturave administrative për zbatimin e projektit “Zhvillimi i rrugëve bashkiake”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve

Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe marrëdhënieve me Publikun, Njësitë Administrative dhe të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI